

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji”

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti “Marin Barleti””

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Erika Melonashi


Dr. Blerta Bodinaku



Shtator, 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	SHLUJ Universiteti Marin Barleti
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike/ Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Shkresë MASH Nr. 2365 prot., datë 12.04.2006
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër MASH Nr. 377, datë 16.08.2013/ VKA Nr. 505, datë 18.07.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Psikologji”
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Numri i Studenteve (total 2018-2019)	31 studentë



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”

SHLUJ “Universiteti “Marin Barleti”” është Institucion jopublik i arsimit të lartë, licensuar me VKM Nr. 571, në 12.08.2005, “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare jo-publike “Universiteti “Marin Barleti””. Programi Bachelor në “Psikologji” ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike të SHLUJ UMB. Struktura e Fakultetit përbëhet nga 3 departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit dhe Departamenti i Shkencave Politike. Programi Bachelor në “Psikologji” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit. Ky program është licensuar me shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 2365 datë 12.04.2006, “Për hapjen e Programeve të Ciklit të Parë në SHLUJ Universiteti Marin Barleti”. Programi ka kohëzgjatje 3 vjeçare dhe ofrohet me kohë të plotë. Numri total i krediteve të përfuara është 180 ECTS.

Ky program është vlerësuar në kuadër të akreditimit të parë dhe është akredituar me Urdhër të MASH nr. 377, datë 16.08.2013, sipas Vendimit Nr. 505, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit. Kohëzgjatja e akreditimit, sipas legjislacionit të kohës, 6 vite.

Në VKA Nr. 505, datë 18.07.2013, programi i studimit Bachelor në “Psikologji” ka patur vlerësim përfundimtar **Pozitiv**, me këto **rekomandime**:

1. Të ndërtohen sa më shpejtë laboratorë për programin e studimit në nivel Bachelor;
2. Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e vogël të studentëve të pranuar në një vit shkollor;
3. Të shikohet mundësia që një departament të mos mbulojë një numër të madh programesh të nivelit Bachelor (4 programe).

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Periodik (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji”, ofruar nga SHLUJ “Universiteti “Marin Barleti””. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. As. Dr. Erika Melonashi dhe Dr. Blerta Bodinaku, si eksperte të jashtme vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Emisa Isufaj.

SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” është njohur me Draft – Reportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.07.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 46/18 Prot., datë 30.07.2019. SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 2713 Prot.,

datë 09.09.2019 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të japin argumentat e mëposhtme dhe të bëjnë një reflektim si më poshtë:


1. Konstatim i GVJ: *GVJ konstaton se institucioni ka përmbushur rekomandimin pjesërisht. Sikundër theksohet në RVB dhe u konstatua gjatë vizitës në institucion laboratorët e vetëm janë ata të pajisur me kompjutera për zhvillimin e lëndëve si Statistika Sociale dhe SPSS apo Teknologji Informacioni. Konstatimi në RVB në lidhje me ekzistencën e një Laboratori online CogLab nuk u vërtetua gjatë vizitës në Institucion (intervista me personelin akademik, biseda me studentët dhe vëzhgimi i ambjentëve)*

Përgjigja e IAL: Institucioni SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” synon të rrisë nivelin e ushtrimit të praktikës profesionale përgjatë tre viteve të programit Bachelor. CogLab është një Laborator online në fushën e Psikologjisë Kognitive i cili konstaton në demonstrimin e eksperimenteve klasike dhe atyre të fundit në fushën e Psikologjisë Kognitive. CogLab mundëson që pedagogu të ndjekë rezultatet e përvojave të studentëve në secilin nga demonstrimet kognitive interaktive. Studentët më pas mund të mbledhin dhe analizojë të dhëna reale bazuar në grupin e tyre specifik. Kjo përvojë praktike i ndihmon studentët të kuptojnë çdo eksperiment, konceptet themelor të Psikologjisë Kognitive, të dhënat dhe rëndësinë e kërkimit shkencor. CogLab është i disponueshëm në CD dhe përfshin një sërë demonstrimesh në lidhje me vëmendjen, perceptimin, kujtesën shqisore, kujtesën afatshkurtër, kujtesën e punës, proceset e kujtesës, gjuhën, arsyetimin dhe marrjen e vendimeve. Si edhe është përmendur në RVB për herë të parë është përdorur me studentët në lëndën e psikologjisë konjitive. Bashkëlidhur do të gjeni disa imazhe nga CogLab. Labororet e kompjuterave shërbejnë si laboratorë edhe për lëndë të tjera si psh në lëndën e vlerësimit psikologjik, ku studentët kanë mundësi të përpunojnë të dhënat e instrumenteve të ndryshëm të vlerësimit, ose për të parë marrë pjesë në vlerësime apo testime psikologjike online, për të ndjekur dokumentare, leksione apo video të ndryshme ilustruese.

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron mendimin të dhënë në Draft-RVJ me argumentimin si më poshtë. Gjatë vizitës në institucion, dhe sidomos bashkëbisedimit me studentët, GVJ konstatoi se CogLab nuk është një laborator i mirëfilltë online, por vetëm një CD e cila është suplement i tekstit bazë që përdoret në lëndën Psikologji Kognitive (shumica e textbooks cilësorë janë pajisur me CD të tilla që mbartin lexime suplementare, ushtrime, teste etj).

2. Konstatim i GVJ: *Të dhënat e RVB në lidhje me procesin e vlerësimit të performancës, nuk përputhen plotësisht me vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në institucion, veçanërisht përsa i përket transparencës së vlerësimit të performancës dhe mënyrës se si pedagogët informohen në lidhje me këtë vlerësim.*

Përgjigja e IAL: SHLUJ UMB ka bërë përmirësime të vazhdueshme të sistemit të brendshëm të vlerësimit të cilësisë, duke shtuar struktura, procedura vlerësimi dhe duke përmirësuar instrumentet e vlerësimit. SHLUJ UMB në proceset e vazhdueshme të akreditimit të programeve ka demonstruar koherencë në ndryshimet dhe përmirësimet e bëra. Përmendim këtu, si edhe përmendet në raport zgjerimi i



zyrës së cilësisë, shtimi i personelit, ngritja e këshillit të performancës, ndryshime që kanë ndodhur vitet e fundit. Sistemi i ngritur për vlerësimin e performancës funksionon në nivel institucioni dhe është njëtrajtësisht i aplikueshëm në të gjithë anëtarët e stafit. Sistemi i vlerësimit është konfidencial dhe njëkohësisht individualisht transparent për të gjithë anëtarët e stafit. Gjatë vitit akademik 2018-2019 një ndryshim në procedurën e shpërndarjes së informacionit nga koordinatorja e performancës tek drejtuesit e departamenteve mund të ketë krijuar mospërputhjen e përmendur. ShLUJ UMB me përpjekjet që ka bërë demonstroi qartë përkushtimin e tij për ngritjen e një sistemi transparent, të drejtë dhe funksional. [Evidenca e ngarkuar në sistem në datë 19 maj “Dokumentacion lidhur me sigurimin e cilësisë”]

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në funksion të rritjes së cilësisë, por i qëndron mendimit të shprehur në RVJ me argumentin e mëposhtëm. Ndërkohë që dokumentacioni lidhur me sigurimin e cilësisë është mjaft i qartë dhe i strukturuar, gjatë bisedës me pedagogët u konstatuan mospërputhje të rëndësishme mes asaj cka shprehet në dokument dhe realizimin konkret, sidomos përsa i përket transparencës së vlerësimit të performancës dhe mënyrës se si pedagogët informohen në lidhje me këtë vlerësim.

3. Konstatim i GVJ: *Institucioni ka bërë përpjekje në drejtim të ndërtimit të një strukture për vlerësimin e brendshëm të cilësisë si dhe instrumentave përkatës por ende mungon rregullimi përmes një strategjie konkrete e cila vendos objektiva të matshëm.*

Përgjigjja e IAL: Në vazhden e ndryshimeve dinamike dhe në kuadrin e projektit Erasmus + “Përmirësimi i cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri” është risikuar sistemi brendshëm i vlerësimit të cilësisë, janë përmirësuar dokumentacione të ndryshme dhe është hartuar dhe një strategji dhe plan veprimi i përmirësimit të cilësisë me objektiva konkretë të matshëm. [Pjesë nga strategjia i gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese.]

Konstatimi I IAL është reflektuar në seksionin përkatës në Draft RVJ (faq. 22)

4. Konstatim i GVJ: *Personeli akademik me kohë të plotë përbën vetëm 50% të personelit akademik dhe duke filluar nga viti akademik 2016-2017 mungon angazhimi i Profesorëve të Asociuar apo Profesor Doktorëve në këtë program studimi.*

Përgjigjja e IAL: Përlllogaritja e raportit PAE/PAK është bërë bazuar në peshën specifike në kredite që mbajnë pedagogët e brendshëm dhe pedagogët e jashtëm. Konstatohet se ekspertet kanë bërë vlerësimin bazuar në numrin e pedagogëve PAE/PAK. [RVJ, Faqe 10-11]

GVJ konfirmon se raporti PAE/PAK është bërë si në bazë të numrit të pedagogëve ashtu edhe në bazë të ngarkesës (peshës specifike në kredite që ata mbartin- RVJ,faq. 10-11).

5. Konstatim i GVJ: *Biblioteka është mjaft e varfër në tituj për fushën e Psikologjisë. Konstatimi i RVB mbi ekzistencën e një biblioteke online nuk u vërtetua gjatë vizitës në institucion.*

Përgjigja e IAL: ShLUJ UMB ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të pasuruar bibliotekën, dhe do të intensifikojë përpjekjet për të shtuar numrin e librave fizikë. Ndërkohë studentët kanë akses në një sërë burimesh elektronike. Në intranet gjenden një sërë titujsh në fushën e psikologjisë dhe shkencave sociale lehtësisht të aksesueshme.

Për të verifikuar marrveshjen e ShLUJ UMB me bibliotekën EconBiz ju mund të klikoni në:

<https://ëëë.econbiz.de/eb/en/about/econbiz-partner-netëork/partner-countries/albania/>


Duke kërkuar me fjalën kyçe “psychology” në econ biz shfaqen 27.667 artikuj dhe 23.779 libra kryesisht në fushën e psikologjisë organizative por jo vetëm.

GVJ vlerëson përpjekjet e IAL por i qëndron mendimit të shprehur në RVB; ekzistenca e bibliotekës online nuk u vërtetua gjatë vizitës në institucion ndërsa linku përkatës thjesht vërteton ‘partnership’ me EconBiz por jo marrëveshje konkrete mbi përdorimin e bibliotekës online, e cila, përveç të tjerash është e fokusuar në fushën e Ekonomisë.

6. Konstatim i GVJ: *Kriteri që kërkon nga Zyra e financës një raport financiar të detajuar që reflekton aktivitetin financiar të institucionit nuk rezulton i përshkruar në Raporti Vleresimit të Brendshëm. Dokumentacioni përkatës nuk është hedhur në sistem dhe deri në një moment të dytë, mbetet një kriter i paverifikueshëm. Institucioni nuk gjeneron të ardhura nga grante, apo fonde të tjera me qëllim kërkimor, ose studimor. Raporti i auditit nuk shoqërohet me tabela të detajuara që reflektojnë aktivitetin financiar të institucionit. Mungojnë pasqyrat financiare që dëshmojnë qëndrueshmërinë financiare të institucionit ndër vite.*

Përgjigja e IAL: Në gjykimin tonë informacioni i deklaruar sipas formatit të RVB miratuar nga ASCAL, që është një përmbledhje e pasqyrave financiare në vite është mëse i mjaftueshëm për të gjykuar për qëndrueshmërinë financiare të institucionit. Tabelat e paraqitura në RVB janë tabelat përmbledhëse të të ardhurave kalendarike sipas bilanceve të deklaruara në tatime. Po ju dërgojmë bashkëlidhur të ardhura të tjera nga shfrytëzimi për tre vitet e fundit ku mund të gjeni informacione të detajuara edhe në lidhje me të ardhurat nga grante dhe projekte të ndryshme, të cilat janë përmbledhur në tabelat e paraqitura në RVB nën zërat Konsulenca, shërbime dhe Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm). [Bashkëlidhur të ardhurat për zërat e mësipërm për tre vitet e fundit]

GVJ i qëndron mendimit të shprehur në RVJ, në lidhje me mangësitë në raportin e auditit financiar. Informacioni shtesë i dorëzuar vetëm në këtë fazë nga IAL, ngrre pikëpyetje mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura më herët (deklarohen të ardhura shtesë nga grantet apo projektet).



7. Konstatim i GVJ: *Politikat dhe procedurat e ndjekura në funksion të përmirësimit të cilësisë si edhe rezultatet përkatëse nuk janë të publikuara dhe të aksesueshme. Mungon ende evidenca mbi mënyrën sesi rezultatet e raporteve të kontrollit të cilësisë përkthehen në politika apo vendimarrje konkrete.*

Përgjigjja e IAL: Nuk ekziston një dokument i vetëm në të cilin rezultatet e raporteve të kontrollit përkthehen në politika. Si edhe është shpjeguar në evidencën e ngarkuar në sistem në datë 19 maj “Dokumentacion lidhur me sigurimin e cilësisë” faqe 5 dhe 6 përmenden një sërë dokumentash që rrjedhin nga vendimet e këshillit të performancës të cilat sipas rastit dhe natyrës miratohen në Senat, ose Rektorat apo struktura të tjera në formën e udhëzimeve, urdhërave, memove, dokumenteve për tu përgatitur etj. Të gjithë këto dokumente ju bëhen të ditura stafit të UMB nëpërmjet emailit me shpjegimet dhe orientimet e nevojshme.

Në intranetin e institucionit, stafi dhe studentët kanë akses të lirë në këto dokumente (përvec atyre me ntyrë konfidenciale).

GVJ vlerëson përpjekjet e IAL në këtë drejtim por i qëndron mendimit të shprehur në RVJ se “Politikat dhe procedurat e ndjekura në funksion të përmirësimit të cilësisë si edhe rezultatet përkatëse nuk janë të publikuara dhe të aksesueshme. Mungon ende evidenca mbi mënyrën sesi rezultatet e raporteve të kontrollit të cilësisë përkthehen në politika apo vendimarrje konkrete.” Përgjigjja e IAL justifikon konstatimin përkatës të GVJ (nuk ekziston një dokument i vetëm; ose raporti I bëhet I ditur stafit dhe studentëve por jo publikut të gjerë) por nuk jep evidencë për ta hedhur poshtë atë. “

8. Konstatim i GVJ: *GVJ konstatoi se planet mësimore sipas Veprimtarive A-F dhe A-E kanë mospërputhje me VKM dt.24.01.2018, përsa i përket peshës specifike të kategorive, psh. peshë specifike e kategorive A+B është më pak se 70%.*


Përgjigjja e IAL: Sipas VKM 41 dt. 24.01.2018 peshë specifike e kategorive A+B varion nga 65% në 75%. Në programin tonë peshë specifike e kategorive është 66%, brenda intervalit të VKM 41. [RVB tabela nr 11]

Janë marrë masa për ndryshimin e kategorive nga A-F në A-E. Plani me ndryshimet e bëra është në proces miratimi në Senat. % e lëndëve A+B ka shkuar në 69%. Më poshtë tabela që paraqet përqindjet. [Bashkëlidhur do të gjeni planin e miratuar në Departament me veprimtaritë sipas VKM nr 41].

Veprimtarite	ECTS	%	VKM Nr. 41
a	28	15.6	15% - 20%
b	96	53.3	50% - 55%
c	28	15.6	12% -15%
d	22	12.2	10-15%

e	6	3.3	3%-5%
<i>Gjithsej</i>	<i>180</i>	<i>100</i>	

GVJ i qëndron mendimit se planet mësimore sipas Veprimtarive A-E kanë mospërputhje me VKM 41, dt 24.01.2018 ku shprehet specifikisht se “Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve “Bachelor” e “Master i shkencave i integruar” ... (Shtojca Nr. 1). Gjithashtu GVJ përfshin një sqarim të metejshëm të konstatimit në draft raport “*GVJ konstatoi se planet mësimore sipas Veprimtarive A-F kanë mospërputhje me Udhëzimin e 2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (kryesisht në kategoritë C dhe D), ndërsa Planet mësimore sipas Veprimtarive A-E kanë mospërputhje me VKM dt.24.01.2018, përsa i përket peshës specifike të kategorive, psh. peshë specifike e kategorive A+B është më pak se 70%. (RVJ, fq. 26).*




**ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR
AKREDITIMIN E PARË**

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të ndërtohen sa më shpejt laboratorë për programin e studimit në nivelin Bachelor;
- b) Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e vogël të studentëve të pranuar në një vit shkollor;
- c) Të shikohet mundësia që një departament të mos mbulojë një numër të madh programesh të nivelit Bachelor (4 programe).

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “**Të ndërtohen sa më shpejt laboratorë për programin e studimit në nivelin Bachelor**” GVJ konstaton se institucioni **ka përmbushur rekomandimin pjesërisht**. Sikundër theksohet në RVB dhe u konstatua gjatë vizitës në institucion laboratorët e vetëm janë ata të pajisur me kompjutera për zhvillimin e lëndëve si Statistika Sociale dhe SPSS apo Teknologji Informacioni. Konstatimi në RVB në lidhje me ekzistencën e një Laboratori online CogLab **nuk u vërtetua** gjatë vizitës në Institucion (intervista me personelin akademik, biseda me studentët dhe vëzhgimi i ambjenteve).
- b) Për rekomandimin “**Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e vogël të studentëve të pranuar në një vit shkollor**” institucioni **ka përmbushur rekomandimin**. Kështu nga viti shkollor 2012-2013 numri i studentëve pothuajse është trefishuar për cdo vit të ri akademik (2017-2018 18 studentë, krahasuar me 5 studentë në vitin 2012-2013).
- c) Për rekomandimin “**Të shikohet mundësia që një departament mos mbulojë një numër të madh programesh të nivelit Bachelor (4 programe)**” institucioni **ka përmbushur rekomandimin**. Aktualisht Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit ofron 3 programe studimi të ciklit të parë Bachelor, përkatësisht në; “*Punë Sociale*”, “*Psikologji*”, “*Edukim Fizik dhe Sporte*” (Evidence 3. Shkresë Informacion për mënyrën e organizimit të programeve të studimit sipas departamenteve, SHLUJ "Universiteti Marin Barleti"). Duke filluar nga viti akademik 2019-2020, programi Bachelor në Psikologji do të ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Sjelles dhe Shëndetit, i cili gjithashtu do të ofrojë 3 programe në nivel Bachelor (Vendim i Senatit Akademik SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” Nr. 4/19, datë 1/02/2019 mbi “Ristrukturimin e njësisve bazë (Departamenteve) të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”; Kthim Përgjigje i MASR, Nr. 1465/1, datë 01/03/2019; Dokumenti i Minutave, faqe 3).



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

SHLUJ “Universiteti “Marin Barleti”” është Institucion jopublik i arsimit të lartë, licencuar me VKM Nr. 571, në 12.08.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare jo-publike Universiteti Marin Barleti”. Programi Bachelor në “Psikologji” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike të SHLUJ UMB. Programi Bachelor në “Psikologji” është licencuar me shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 2365 datë 12.04.2006, “Për hapjen e Programeve të Ciklit të Parë në SHLUJ Universiteti Marin Barleti”. Programi është akredituar me Urdhër të MASH nr. 377, datë 16.08.2013, sipas Vendimit Nr. 505, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit. Programi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit, të reflektuara në Statutin dhe Rregulloren e UMB, për të formuar psikologë me formim etik dhe të aftë të ushtrojnë profesionin sipas kuadrit ligjor dhe profesional në vend në përputhje me Ligjin për Urdhrin e Psikologut (UP) në Republikën e Shqipërisë 40/2016.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	GVJ konstaton se programi Bachelor në “Psikologji” është i hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit, të reflektuara në Rregulloren Akademike të UMB [Evidencë 6.3. Rregullore Akademike e SHLUJ Universiteti Marin Barleti] dhe Rregulloren e Programit të Studimit [Evidencë 9. Rregullore e Programit të Studimit]. Ky program përshkruan objektiva të qartë përsa i përket zhvillimit të aftësive dhe formimit të përgjithshëm të lidhura me sjelljen etike dhe profesionale dhe synon të hedhë bazat për zhvillim profesional të mëtejshëm në nivel master, në përputhje me Ligjin për Urdhrin e Psikologut (UP) në Republikën e Shqipërisë 40/2016, sipas të cilit psikologët mund të regjistrohen në UP dhe të pajisen me Leje për Ushtrimin e Profesionit vetëm nëse plotësojnë dy nivele studimi. GVJ vëren se megjithëse nuk ka një vlerësim të mirëfilltë të tregut të punës, miratimi së fundmi i Ligjit për Urdhrin e Psikologut (UP) në Republikën e Shqipërisë 40/2016, që lejon përfshirjen e profesionit në listën e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, si dhe një sërë VKM të miratuara vitet e fundit për përfshirjen e psikologut në shërbimet publike në vend, krijojnë premisat për rritjen e kërkesës për profesionin e psikologut në vend. Në këtë perspektivë program i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;

Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

GVJ konstaton se nuk ekziston një strategji e mirëfilltë zhvillimi e publikuar e UMB përmes të cilës të mund të vlerësohet përputhshmëria e programit me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Gjithsesi në përputhje me nevojën e studentëve për të thelluar studimet në nivel master, UMB ka çelur programet master shkencor në psikologji shkollore dhe zhvillimi si dhe master profesional në psikologji ligjore (Evidenca: RVB). Shqyrtimi i rregullores së programit dhe i syllabuseve të lëndëve, sugjeron se programi synon dhe i mëshon formimit të përgjithshëm bazë mbështetur në metoda dhe parime shkencore dhe bashkëkohore. Gama e lëndëve dhe tematikat, shkathtësitë dhe shprehitë e reflektuara në syllabuset e lëndëve sugjerojnë se programi është i orientuar drejt formimit të përgjithshëm të studentit. Një e dyta (1/2) e lëndëve të përfshira në program, mbulojnë disiplina të shkencës së psikologjisë; lëndët me orientim filozofik, sociologjik dhe antropologjik, plotësojnë ¼ e planit mësimor dhe lëndët e formimit plotësues zënë ¼. Përmbajtja e programit përputhet me objektivat e programit për një formim të përgjithshëm të orientuar drejt zhvillimit të vlerave, më tepër se sa aftësive konkrete teknike dhe profesionale.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;
- c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

GVJ konstatoi se Programi i formimit Bachelor në "Psikologji" përputhet me kuadrin ligjor aktual, duke përfshirë Ligjin për Urdhrin e Psikologut, Ligjin për Rregullimin e Profesioneve, si dhe njohjen e gjerë që ka profesioni i psikologut në tregun e shërbimeve publike dhe jopublike në Shqipëri.

Nuk ekziston një studim tregu i publikuar në lidhje me nevojën aktuale për profesionin e psikologut në vend, rajonal, apo ndërkombëtar. Duke u bazuar në vlerësimin e udhëzimeve dhe VKM-ve të cilat parashikojnë përfshirjen e psikologut në shërbimet publike në vend, është vlerësuar në mënyrë informale rritja e interesit për profesionin e psikologut. Institucioni ka kryer një vlerësim të përgjithshëm parashikues të numrit të pritshëm të studentëve për vitet në vijim, duke u mbështetur në statistikat e regjistrimeve të deritanishme si dhe ka ndërtuar një databazë të numrit të studentëve të regjistruar në IAL të tjera në programe të njëjta [Evidenca RVB].

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;

Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

GVJ konstaton se Programi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky konstatim u realizua përmes shqyrtimit të rregullores së programit, misioni, qëllimet dhe objektivat, si dhe shqyrtimi i përmbajtjes së syllabuseve [Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve; Evidenca 9: Rregullore e programit të studimeve]. Misioni dhe qëllimi i programit për të formuar profesionistë me një profil të lartë të sjelljes etike dhe profesionale është në

përputhje me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e vlerave shoqërore kombëtare.

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji” është hartuar në përputhje me misionin e SHLUJ UMB, në përputhje me misionin dhe emërtimin e Departamentit përkatës, në përputhje me me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore përkatëse dhe kornizën më të gjerë ligjore që lidhet me rregullimin e ushtrimit të profesionit të psikologut, të tillë si Ligji 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, Ligji 10 171 “Për Rregullimin e Profesioneve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimi 514 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve.”

Programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit për të formuar profesionistë me një profil të lartë të sjelljes etike dhe profesionale në përputhje me interesat kombëtare.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Mbështetur në takimet e kryera me Rektorin, Dekanen e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, dhe përgjegjësën e Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit, GVJ konfirmon se ky fakultet është njësi kryesore e UMB që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta apo të ndërthurura. Fakulteti ofron programe në disiplina dhe nivele të ndryshme. Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë Dekani, Zv. Dekani dhe përgjegjësit e njësive bazë.

Dekani është autoriteti më i lartë i Fakultetit, pasuar Zv. Dekani. nga përgjegjësit e njësive bazë dhe koordinatoret e njësive bazë, të cilët funksionojnë si asistentë të përgjegjësit të njësisë. Kriteret e përzgjedhjes, funksionet e autoriteteve drejtuese të UMB dhe fakulteteve përkatëse përshkruhen në Rregulloren Akademike të SHLUJ Universiteti Marin Barleti [Evidencë 6.3.] dhe Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike [Evidencë 6.2].

Personeli akademik përbëhet nga profesorë, lektorë dhe asistent-lektorë me kohë të plotë ose të pjesshme. Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik pëshkruhen në kontratat përkatëse, dhe në Statutin e UMB, Kreu V, neni 62 dhe 63 si dhe kreu VI, neni 65 – 70 [Evidencë 2.Aneks/Shtojcë Statuti dhe Rregullorja Akademike]. Përzgjedhja e stafit akademik kryhet në përputhje kualifikimet dhe ekspertizën e stafit në përgjigje të nevojave të Departamentit për lëndë të caktuara. Fakulteti siguron për personelin akademik aktivitete që synojnë përditësimin e dijeve dhe edukimin në vazhdim.

Zyra e burimeve njerëzore disponon dosjet e detajuara të të gjithë personelit, efektiv, apo me kontratë, duke përfshirë CV-të dhe dëshmitë e përditësuar të kualifikimeve apo titujve dhe gradave shkencore.

Në nivel Fakulteti personelit efektiv për vitin akademik 2018 – 2019 përfaqëson 39.5% të gjithë personelit, ku peshën më të madhe e zë personeli akademik i Departamentit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit me 76% të personelit të gjithë Fakultetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Struktura e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, pranë SHLUJ UMB përbëhet nga 3 departamente [Evidenca: Tabela 1 Struktura didaktike e Fakultetit të Drejtësisë, Shkencave Sociale e Politike]

- Departamenti i Drejtësisë
- **Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit**
- Departamenti i Shkencave Politike

Secili departament ka strukturën e vet drejtuese dhe organizative, të përbërë nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe koordinatori i njësisë bazë. Departamentet ofrojnë programet e veta të studimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimit.

Për vitin akademik 2018-2019: në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike angazhohen **35 PAE** dhe **53 PAK**. Njësitë bazë të këtij fakulteti plotësojnë kriterin ligjor për numrin dhe kualifikimin e personelit akademik efektiv, sikurse konstatohet në analizën më poshtë [Tabela 1, Aneksë]:

- Në Departamentin e Drejtësisë, angazhohen 10 PAE (1 Prof. As.; 6 Dr.; 3 Msc.), 6 PAK (2 Prof. As.; 4 Dr.).
- Në Departamentin e Shkencave Politike, angazhohen 8 PAE (2 Prof. As.; 4 Dr.; 2 Msc.), 1 PAK (1 Prof. Dr.).
- Në Departamentin e Shkencave Sociale dhe Edukimit, angazhohen 17 PAE (2 Prof. Dr.; 2 Prof. As.; 6 Dr.; 7 Msc), 46 PAK (3 Prof. Dr.; 5 Prof. As.; 13 Dr.; 25 Msc.).

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit përfaqëson departamentin më të madh të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, me 76% të personelit akademik të gjithë fakultetit.

Aktualisht, në këtë Departament raportohen 19 PAE përkundrejt 56 PAK [Evidenca: Tabela 2. Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamenteve]. Gjithsesi GVJ konstatoi se ka një mospërputhje në shifra me Tabelën 1 e cila raporton mbi stafin e fakultetit; në këtë tabelë rezulton se për vitin akademik 2018-2019 departamenti i këtij programi ka 17 PAE dhe 46 PAK.

Përsa i përket kualifikimit akademik nga **19 anëtarët PAE**: 2 pedagogë raportohen me titullin akademik “Profesor”, 2 pedagogë me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, 6 pedagogë me gradën “Doktor i Shkencave” dhe 9 pedagogë me kualifikimin “Master i Shkencave”. Si **PAK ka 56 pedagogë** prej të cilëve: 2 “Profesorë”, 4 “Profesorë të Asociuar”, 18 pedagogë me gradën “Doktor i Shkencave”, 1 pedagog në ndjekje të studimeve Doktorale dhe 27 pedagogë me kualifikimin “Master i Shkencave”.

Edhe në këtë rast GVJ konstatoi se ka mangësi në raportimin e gradave dhe titujve për pedagogët; të dhënat raportohen vetëm për 52 pedagogë PAK dhe jo 56 sikundër deklarohet. Gjithashtu në 2 raste, pavarësisht se emri i pedagogut është vendosur në tabelë, nuk raportohet grada apo titulli i PAK përkatës.

Në përmbyllje, GVJ konstatoi se ka mospërputhje/mangësi në raportimin e numrit të pedagogëve PAE/PAK të departamentit përgjegjës si dhe mungojnë të dhënat për kualifikimet e tyre akademike në disa raste.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Rekrutimi i stafit akademik të programit ndjek të njëjtat procedura dhe kriteret si në çdo program tjetër, konform statutit të UMB dhe kontratave tip të institucionit. Procesi i rekrutimit mbështetet tek kualifikimi dhe fusha e ekspertizës së personelit akademik në raport me kërkesat e programit. Programi drejtohet nga një këshill shkencor (Tabela 3, Aneksë), i kryesuar nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe dy anëtarë të tjerë. Ngarkesa mësimore e personelit akademik përcaktohet në bazë të nevojave të njësisë bazë për programin përkatës dhe përshkruhet në marrëveshjet individuale. Nga shqyrtimi i i planit mësimor, PAE ka një ngarkesë mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29 të MASR të datës 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personalit akademik në Institucionet e arsmit të lartë”.

Institucioni ka paraqitur evidencë për ngarkesën totale të stafit duke filluar nga viti akademik 2016-2017 [Evidenca 12: Ngarkesa totale e stafit të angazhuar në programin e studimit]. Konstatohet se shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik efektiv të departamentit, varion nga një angazhim total prej 285 orësh mësimore në programin Bachelor në “Psikologji”, në një angazhim minimal prej 60 orësh mësimore për programin specifik të studimit. Ndërkohë ngarkesa mësimore totale e personelit akademik efektiv të departamentit, arrin vlerën maksimale me 323 orë mësimore për vitin akademik 2018-2019, dhe 364 orë mësimor për vitet akademike 2017-2018 dhe 2016-2017. Përsa i përket personelit akademik me kontratë vërehet se ngarkesa maksimale e konstatuar është 195 orë/vit.

Përsa i përket raportit PAE/PAK në vite, për vitin **akademik 2013 – 2014**, raporti PAE me PAK ka qënë 13/7; pra 65% e stafit të angazhuar në mësimdhënie për programin përkatës është personel akademik efektiv. Ndërkohë përsa i përket ngarkesës mësimore, 77% e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 23% nga PAK.

Për vitin **akademik 2014 – 2015**, raporti PAE me PAK ka qënë 16/5; pra 76% e stafit të angazhuar në program është PAE dhe vetëm 24% PAK. Përsa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore, 83% e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 17% nga PAK

Për vitin **akademik 2015 – 2016**, raporti PAE me PAK ka qënë 15/4, ose 79% e stafit të angazhuar në mësimdhënie është PAE përkundrejt 21% PAK. Përsa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore, 80% e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 20% nga PAK

Për vitin **akademik 2016 – 2017**, raporti PAE me PAK ka qënë 10/7, ku konstatohet një ulje e numrit të personelit akademik efektiv përkundrejt atij me kontratë; në këtë vit akademik 59% e stafit është PAE dhe 41% PAK. Përsa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore, 75% e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 25% nga PAK

Në vitin **akademik 2017 – 2018**, raporti PAE PAK, ngelet në shifra të ngjashme 11/7, ose 61% PAE përkundrejt 39% PAK . Përsa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore, 75% e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 25% nga PAK.

Së fundmi, konstatohet një mospërputhje në raportimin e numrit të pedagogëve të angazhuar në programin e studimit në vitin akademik **2018 – 2019**. Ndërkohë që nga Tabela 4 rezultojnë një raport 9PAE/9PAK (pra 50%-50%), nga Evidenca 10 'Plani mësimor i lidhur me stafin akademik në vite' rezultojnë një raport 9PAE/8PAK ose 53% PAE, 47% PAK. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është llogaritur pikërisht me këtë raport, 9/8 dhe rezultojnë se 65% e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 35% nga PAK [Evidenca 10. Plani mësimor i lidhur me stafin akademik në vite]. Gjithsesi për shkak të mospërputhjes së konstatuar më lart, është e paqartë nëse kjo përlogaritje e shpërndarjes së ngarkesës është e saktë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:


Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

[Evidenca: Tabela 4 Stafit akademik për programin e studimit]

Nga viti akademik **2013 –2014** vërehet tendenca për rritje të numrit të personelit akademik me formim në fushën e psikologjisë. Po ashtu, vihet re edhe një rritje e raportit të personelit akademik efektiv që mbajnë grada apo tituj shkencorë kundrejt personelit me kontratë. Për vitin **akademik 2013 – 2014**, raporti PAE me PAK ka qënë 13/7, në të cilin raporti PAE kundrejt PAK me Dr. ka qënë 5/3, ndërsa për personelin me master shkencor ka qënë 7/4. Në program ka pasur 1 PAE me titullin Profesor.

Për vitin **akademik 2014 – 2015**, raporti PAE me PAK ka qënë 16/5, në të cilin raporti PAE kundrejt PAK me Dr. ka qënë 6/1, ndërsa për personelin me master shkencor ka qënë 8/4. Në program ka pasur 1 PAE me titullin Profesor dhe 1 PAE me titullin Profesor i Asociuar.

Për vitin **akademik 2015 – 2016**, raporti PAE me PAK ka qënë 15/4, në të cilin raporti PAE kundrejt PAK me Dr. ka qënë 4/2, ndërsa për personelin me master shkencor ka qënë 10/2. Në program ka pasur 1 PAE me titullin Profesor.



Për vitin **akademik 2016 – 2017**, raporti PAE me PAK ka qënë 10/7, në të cilin raporti PAE kundrejt PAK me Dr. ka qënë 6/4, ndërsa për personelin me master shkencor ka qënë 4/3. Në program nuk ka pasur për atë vit personel akademik efektiv, apo me kontratë që të mbajë titullin Profesor, apo Profesor i Asociuar.

Për vitin **akademik 2017 – 2018**, raporti PAE me PAK ka qënë 11/7, në të cilin raporti PAE kundrejt PAK me Dr. ka qënë 8/5, ndërsa për personelin me master shkencor ka qënë 3/2. Në program nuk ka pasur për atë vit personel akademik efektiv, apo me kontratë që të mbajë titullin Profesor, apo Profesor i Asociuar.

Së fundmi, në vitin akademik **2018 – 2019**, raporti PAE me PAK është 9/9, në të cilin raporti PAE kundrejt PAK me Dr. është 8/6, ndërsa për personelin me Master është 1/3. Në këtë program studimi nuk ka personel akademik efektiv, apo me kontratë që të mbajë titullin Profesor, apo Profesor i Asociuar. Gjithsesi duhet ritheksuar mospërputhja e përmendur edhe më lart në raportimin e numrit të pedagogëve të angazhuar në programin e studimit për këtë vit akademik. Ndërkohë që nga Tabela 4 rezultojnë një raport 9PAE/9PAK (pra 50%-50%), nga Evidenca 10 'Plani mësimor i lidhur me stafin akademik në vite' rezultojnë një raport 9PAE/8PAK ose 53% PAE, 47% PAK.

Të dhënat më të detajuara për Departamentin dhe stafin e tij në vite, janë paraqitur në Anekse, Tabela 4 **Stafi akademik për programin e studimit**

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ka gradën “Doktor i Shkencave” ose “Master i Shkencave”. Përgjatë viteve vërehet rritje e numrit të personelit akademik me gradën “Doktor i Shkencave”, nga 8 në vitin akademik 2013-2014, në 14 në vitin akademik 2018-2019. Nga ana tjetër, duke filluar nga viti akademik 2016-2017, në këtë program nuk është angazhuar asnjë staf akademik me titull Profesor i Asociuar apo Profesor. Të dhënat më të detajuara për personelin e Departamentit kualifikimin e tyre, janë paraqitur në Anekse, Tabela 2. Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamenteve.

Të dhëna sipas moshës së personelit PAE dhe PAK

Përsa i përket përfaqësimit moshor, në RVB personeli akademik, për vitin akademik 2018-2019, deklarohet se varion nga mosha 35 – 55 vjeç, ku nga 8 PAE me Dr., 4 janë në moshën 35 – 45, dhe 4 në 45 – 55. Një PAE me Msc është në fashën moshore 35 – 45.

Përsa i përket PAK, 5 me Dr. janë në fashën moshore 35 – 45 dhe 1 në fashën moshore 46 – 55. PAK me MSc raportohen 3 në moshën 35 – 45.

Të dhënat në lidhje me moshën gjenden në seksionin e Anekseve, Tabelat 6.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

I gjithë personeli akademik efektiv, ose me kontratë është i pajisur me kontratën përkatëse në të cilën shpjegohen detyrat dhe përgjegjësitë e të dy palëve kontraktuale [Evidencë 13.1 Kontratë pune]. Zyra e burimeve njerëzore disponon dosjet përkatëse për secilin pedagog. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit janë të përshkruara në statutin e UMB dhe Rregulloren e Fakultetit [Evidenca 6.2. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë, Shkencave Politike e sociale; Evidenca 2 Aneks Shtojcë: Statuti dhe Rregullorja akademike] dhe shpallja e vendeve vakante në përputhje me nevojat e njësive bazë bëhet në mënyrë transparente dhe publike.

Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës i Njësive Bazë është Sekretaria Mësimore, e cila funksionon për gjithë Fakultetin. Po ashtu, në mbështetje të aktivitetit të Njësive Bazë është edhe Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila monitoron përmbushjen e kriterëve të përgjedhjes së personelit akademik dhe përditësimin e tyre. GVJ konstaton nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik efektiv dhe me kontrate se të dhënat e deklaruara në RVB janë në përputhje me të dhënat e vlerësuara gjatë vizitës në institucion. Me përjashtim të të dhënave në lidhje me moshën, ku sipas vlerësimit të CV-ve të personelit akademik, në disa raste moshë nuk përputhet me moshën e deklaruar, të dhënat e tjera përkojnë në një shkallë të lartë. GVJ gjykon se kjo mospërputhje nuk ndikon në përmbushjen e standardeve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj. GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për procedurat e rekrutimit dhe monitorimin e respektimit të kriterëve të rekrutimit është Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo njësi është përgjegjëse për shpalljen e vendeve vakante dhe kriterëve sipas nevojave të njësive bazë dhe programit përkatës [Evidenca 15.1 Kërkesa për rekrutim; Evidenca 15.2. Shpallja e vendeve vakante]. Zyra e burimeve njerëzore bazohet në Ligjin për Arsimin e lartë, Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, aktet nënligjore të MASR dhe Statutin e UMB. Konstatohet se 40% e personelit akademik të Fakultetit të Drejtësisë, dhe Shkencave Sociale e Politike është personel efektiv. Në nivel Njësive bazë, 45% e stafit është personel efektiv, ndërsa në nivel programi, raporti PAE/PAK është 50:50. Pra personeli akademik me kohë të plotë përbën më pak se 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit [Tabelat 1 & 2] dhe ngarkesa mësimore që PAE mbulon shkon deri në 65% të ngarkesës totale [Evidenca 10. Ngarkesa totale e stafit të angazhuar në programin e studimit]. Gjithashtu Institucioni ndërmerr vlerësime periodike të performancës së personelit akademik, përfshirë vetëvlerësimin e pedagogëve, vlerësimin e studentëve dhe nga vlerësimin nga drejtuesit e Njësive bazë [Evidenca 8. Dokumentacion lidhur me sigurimin e cilësisë].</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se raportet e vlerësimit për personelin akademik nuk u bëhen me dije dhe nuk u dorëzohen në mënyrë individuale personelit akademik, siç doli në pah gjatë intervistave me pedagogët e angazhuar më program. Në disa raste, pedagogët gjatë intervistës në grup u shprehën se nuk janë në dijeni të mënyrës si kryhet vlerësimi i performancës së tyre. Institucioni ka ndërtuar një bazë të dhënash dhe e përditëson atë periodikisht, duke përfshirë të dhënat e përditësuara për personelin, raportet e rekrutimeve, njoftimet etj. Njësia përgjegjëse për këtë dazë të dhënash është Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent.,..</p>	<p>Nga vizita në Institucion GVJ konstaton se Institucioni zotëron një bazë të dhënash të hollësishme për të gjithë anëtarët e personelit akademik. Baza e të dhënave përmban dosjet personale (CV-të, dëshmitë e kualifikimeve dhe ekspertizes, dëshmitë për vendin e punës -në rastin PAK-, kontrata dhe marrëveshjet për ngarkesën mësimore, etj.)</p> <p>Institucioni e zotëron listën e plotë të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor shkencor dhe atij administrativ. Njësia përgjegjëse për këtë dazë të dhënash është Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>UMB përmes Drejtorisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, shpall vendet vakante në përputhje me kërkesat e njësive bazë, ose programeve specifike. Kriteret për rekrutimin e personelit akademik janë të parashikuara në Statutin e UMB, përkatësisht kreu IV, nenet 63 – 70 si dhe në rregullorën e Fakultetit.</p> <p>Përgjithësisht, Institucioni angazhon si titullarë lëndësh në këtë program studimi, personel akademik që mbajnë të paktën gradën Dr. Në fakt gjatë hulumtimit të planit mësimor dhe syllabuseve, u konstatua se ky rregull ka gjetur përjashtim vetëm në dy raste.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik i UMB mbështetet nga personel ndihmës për realizimin e orëve në laboratorin e informatikës. Personeli ndihmës është i angazhuar dhe në dispozicion të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe përmbushjes së objektivave të programit.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës në institucion u konstatua se në procesin e praktikës, studentëve u garantohet supervizim dhe mbështetje e plotë. Numri i ulët i studentëve, e bën raportin instruktor/student plotësisht të realizueshëm. Praktika cilësore përbën një nga objektivat e programit.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe komunikimit me stafin akademik GJV konstatoi se institucioni organizon trajnime për kualifikimin e mëtejshëm të stafit. Gjatë vizitës në institucion u përmend Programi trajnues për aftësimin teknologjik të stafit [Evidencë për aktivitetet trajnimet e zhvilluara me stafin për teknologjinë – nga vizita në institucion]. Institucioni gjithashtu mbështet pjesëmarrjen individuale të personelit në aktivitete që synojnë edukimin dhe kualifikimin e vazhduar, por mungon evidence e trajnimeve specifike dhe të qëllimshme që lidhen me fushën specifike të studimit (psikologjinë)</p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni ndjek procedura transparente në lidhje me rekrutimin e personelit akademik; ka një bazë të dhënash të detajuar dhe kujdeset për përditësimin e saj; angazhon personelin ndihmës në arritjen maksimale të misionit dhe objektivave të programit.</p> <p>Të dhënat e RVB në lidhje me procesin e vlerësimit të performancës, nuk përputhen plotësisht me vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në institucion, veçanërisht për sa i përket transparencës së vlerësimit të performancës dhe mënyrës se si pedagogët informohen në lidhje me këtë vlerësim.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë përbën vetëm 50% të personelit akademik dhe duke filluar nga viti akademik 2016-2017 mungon angazhimi i Profesorëve të Asociuar apo Profesor Doktorëve në këtë program studimi.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

UMB i ka të organizuara mjediset mësimore dhe ato në mbështetje të procesit mësimor në dy kampuse; njëri në funksion të programeve të ciklit të parë Bachelor dhe administratës dhe tjetri në funksion të programeve të studimit të ciklit të dytë dhe programit të formimit në edukim fizik. Kampusi i dytë është i pajisur me palestër dhe pajisje mbështetëse për edukimin fizik. Të dy kampuset janë të pajisura me mjedisë mbështetëse dhe shërbime të tjera, në funksion të mbarëvajtjes së përgjithshme të aktivitetit mësimor dhe mirëfunksionimit të studentëve dhe personelit të institucionit. Të tilla mjedisë përfshijnë mensën, mjedisë shlodhëse, bibliotekën, zyrat e pedagogëve etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare

34

1802.8

• Salla për aktivitete promovuese	6	1276.1
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	8	
• Laboratorë për lëndët	5	217.5
• Laboratorë informatike	7	278.5
• Salla interneti (ëëëëireless në të gjithë sipëfaqen, godinat)	1+2	5500
• Salla për bibliotekë	2	80.66
• Mjedis për fotokopjime, librari, etj	2	40.2
• Zyrë informacioni për studentët	6	106.97
• Korridore/holle	2	354.1
• Mjedise sportive (fushë e jashtme)	3	970.4
• Mjedise shërbimi për të tretë	5	
• Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	13.5
• Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj.	6	1864.5
• Nyje hidrosanitare për studentët	49	196
• Norma m²/për student	7 m ² /student	

Mjediset për stafin:

• Zyra për Dekanin/Zvdekanin/ Kancelarin	5	120.51
• Zyra për sekretarinë mësimore	2	64.15
• Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	3	91.65

GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në RVB përputhen me vëzhgimet e kryera gjatë vizitës së institucion (Tabelat 7, Aneks).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Planimetria e institucionit: konsiston në një tabelë përmbledhëse të mjediseve [Evidenca 4. Planimetria Relacion Infrastruktura]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	GVJ konstaton se Programet e lëndëve mbështeten në një shkallë të madhe në literaturë në gjuhën shqipe dhe plotësohen nga literaturë bashkëkohore e huaj. Literatura në gjuhën shqipe në disa raste nuk është mjaftueshëm e përditësuar, duke reflektuar një kufizim të tregut aktual të teksteve akademike. Në rastin e programit të dy lëndëve, literatura e përdorur, nuk përputhet mjaftueshëm me qëllimin dhe objektivat e lëndës.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Biblioteka e institucionit kishte një numër mjaft të kufizuar tekstesh fizike dhe titujsh në gjendje [Evidencë 17. Lista e librave të Psikologjisë]
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	Megjithëse RVB konstaton se institucioni është i pajisur me bibliotekë elektronike dhe laborator në shërbim të studentëve, gjatë vizitës, nuk u bë e mundur të verifikohet aksesimi në bibliotekën elektronike, si pasojë e një defekti, apo keqfunksionimi.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë	Konstatimi në RVB se Institucioni ndjek një politikë përmes të cilës të synojë të shtojë numrin e titujve dhe materialeve didaktike fizike, ose elektronike në mënyrë periodike, nuk u

<p>një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>verifikua dot mjaftueshëm si pasojë e problemeve teknike në bibliotekë gjatë vizitës në institucion të GVJ.</p> <p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe shpall oraret e studimit dhe të aksesit në përputhje me oraret e studimit dhe nevojat e tyre.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se në raport me numrin e studentëve dhe programeve që ofron, institucioni ofron mjedise të mjaftueshme, të tilla si klasa mësimore dhe laboratorë informatike. Klasat nuk janë të pajisura me pajisjet bazë, por u informuam se pedagogët e lëndëve përkatëse i sjellin ato në sallë para zhvillimit të leksionit.</p> <p>Mjediset janë përgjithësisht të vogla por numri i reduktuar i studentëve bën që ky fakt mos paraqitet si problem.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës u konstatua se UMB është i pajisur me laboratorë kompjuterikë dhe të informatikës, të cilët kanë një numër të mjaftueshëm kompjuterash funksionalë dhe që mirëmbahen nga personeli mbështetës.</p> <p>Me përjashtim të laboratorëve kompjuterikë, apo CD-ve didaktike që përdoren gjatë orëve të caktuara mësimore, institucioni nuk krijon mundësi dhe hapësira në të cilat të mund të zhvillohet praktika profesionale. Megjithatë, Institucioni garanton zhvillimin e praktikave mësimore përmes bashkëpunimeve institucionale me institucione që ofrojnë shërbime psikologjike në vend, publike, ose private.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni garanton mjedise të mjaftueshme për kryerjen e procesit mësimor, në mbështetje të procesit mësimor, si dhe mbështetëse të funksionimit global të studentëve në institucion. Klasat, laboratorët e informatikës, dhe të aktivitetit fizik, biblioteka, mjediset shlodhëse, edhe pse të vogla dhe të pajisura në nivel bazik, përmbushin në mënyrë të mjaftueshme nevojat e programit.</p> <p>Biblioteka është mjaft e varfër në tituj për fushën e Psikologjisë. Konstatimi i RVB mbi ekzistencën e një biblioteke online nuk u vërtetua gjatë vizitës në institucion.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

UMB është shoqëri tregtare, e cila gjeneron të ardhura përmes shërbimeve që ofron dhe tarifave të studimit. Organet administruese të aktivitetit financiar të UMB janë Administratori, Përgjegjësi i financës dhe Financieri. Kostoja financiare për student në vitin akademik 2018 – 2019 ka rezultuar 1250 Euro [Evidenca 9. Kosto Studenti]. UMB si shoqëri tregtare ka detyrimin të nënshtrohet në mënyrë periodike (vjetore) auditeve të administruara nga ekspertë të pavarur. Njëkohësisht UMB i nënshtrohet auditeve financiare, të plota, apo të pjesshme në varësi të kërkesave të aksionerëve. Burimet e të ardhurave të UMB janë: tarifatat e studentëve, shërbimet e qeradhënies, ofrimi i trajnimeve dhe kualifikimeve afatshkurtra specifike, konsulenca, apo burime dytësore të gjeneruara nga kursi i këmbimit valutor [Evidenca 6.4. Kapacitetet menaxhuese financiare].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim - 0%
- Konsulencat, shërbimet – 1.04%
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit – 97.59%
- Sponsorizimet – 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) – 1.14%
- Donacionet, aktivitetet sigurose, fondacione etj – 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) – 0%
- Të tjera (dhënie mjedisi me qera, kurse këmbimi valutor) – 0.23

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Sipas RVB, nga viti akademik 2013 - 2014 deri në vitin akademik 2017 – 2018, mesatarja e kostove të studimit për student përllogaritet 1404 Euro. Të dhënat e pasqyruara në RVB përkojnë me të dhënat e verifikuara gjatë vizitës në institucion. Të dhënat në lidhje me shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit nuk janë reflektuar në RVB dhe gjithashtu rezultojnë të paverifikueshme në mënyrë të mjaftueshme përmes dokumentacionit plotësues, pasi dokumentat financiare të hedhura në sistem janë të gati të palexueshme dhe kostot e studimit për student, sipas vitit nuk janë paraqitur në mënyrë të detajuar në dokumentacionet plotësuese të hedhura në sistem. [psh., Evidenca 9. Kosto Studenti; Evidenca 6.4. Kapacitetet menaxhuese financiare].

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Raporti i auditit, pasqyrat financiare, përmbledhëse e kostove të studentëve. [Evidenca 7.2. Auditim i Brendshëm].

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standarleve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se UMB kryen auditim financiar vjetor të brendshëm, realizuar nga ekspertë të pavarur. Me kërkesë të aksionerëve, UMB mundet të kryejë auditime të tjera të plota ose të pjesshme, në përputhje me kërkesën [Evidenca 7.2. Auditim i Brendshëm]. Raporti i auditit të brendshëm nuk përmban tabelën e detajuar të detyrimeve financiare, pagave, shpenzimeve operative etj. Raporti i auditit të brendshëm nuk përmban pasqyrë të granteve të huaja të përfituara, apo kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit të ciklit të parë. Raporti i paraqitur i auditit reflekton vetëm konstatime në lidhje me përputhshmërinë midis kontratave me studentët dhe arkëtimeve, saktësinë e arkëtimeve, fluksin e lëvizjeve në arkë, përlogaritja e pagesave dhe ligjshmëria e tyre.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni ndjek politika të cilat synojnë të garantojnë qëndrueshmëri financiare, si psh. përfshirja e UMB në Barleti Group, si një faktor që synon të garantojë qëndrueshmërinë financiare. Kriteri që kërkon nga Zyra e financës një raport financiar të detajuar që reflekton aktivitetin financiar të institucionit nuk rezulton i përshkruar në RVB. Dokumentacioni përkatës nuk është hedhur në sistem dhe deri në një moment të dytë, mbetet një kriter i paverifikueshëm.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Pjesa më e madhe e të ardhura të gjeneruara nga institucioni e kanë origjinën tek tarifat studentore.</p> <p>Institucioni nuk gjeneron të ardhura nga grante, apo fonde të tjera me qëllim kërkimor, ose studimor.</p> <p>Raporti i auditit nuk shoqërohet me tabela të detajuara që reflektojnë aktivitetin financiar të institucionit.</p> <p>Mungojnë pasqyrat financiare që dëshmojnë qëndrueshmërinë financiare të institucionit ndër vite.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni është angazhuar në krijimin e një sistemi të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Me vendim të Rektorit Nr.50 7.5.2018 është ngritur Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (Tabela 8, Aneksë). Kjo zyrë ushtron një sërë funksionesh në shërbim të përmirësimit të kurrikulave apo cilësisë së mësimdhënies duke prodhuar raporte të cilat paraqiten në nivel Rektorati dhe Senati akademik. Për të realizuar këtë funksion Zyra lehtëson proceset e vlerësimit nga studentët, vetë-vlerësimit të pedagogëve, përmes shpërndarjes së formularëve përkatës [Evidenca 8.2. Model i pyetësorit të studentëve; 8.3. Modeli i pyetësorit online 8.4. Formular vetë-raportimi]. Gjatë vizitës në institucion u konstatua ngritja e një strukture të re, Këshilli i Vlerësimit të Performancës, e cila merret specifikisht me vlerësimin e performancës së stafit, duke marrë parasysh të dhënat nga një sërë burimesh, përfshi studentët, eprorët, vetëvlerësimi [Evidencë 13, Vendim i Senatit për Ngritjen e KVP]

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

RVB nuk paraqet të dhëna në lidhje me këta tregues. Gjatë vizitës në institucion u kërkua të vihej në dispozicion raporti i fundit i vlerësimit nga studentët [Evidenca 8. Dokumentacion lidhur me sigurimin e cilësisë; Evidenca 8.1. Pjesë nga raporti i vlerësimit të studentëve i semestrit të parë]. U konstatua se raportoi shtjellohet në rang institucioni dhe jo njësie bazë; pjesëmarrja e studentëve të psikologjisë ishte relativisht e ulët - 18 nga 38 studentë ose 47% kanë marrë pjesë në anketim. Raporti ka një natyrë përshkuese mbi procedurën e ndjekur dhe rezultatet në përqindje; mënyra sesi rezultatet përkthehen në hapa të mëtejshme konkrete nuk është e qartë.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë


Institucioni është angazhuar në krijimin e një sistemi të brendshëm të sigurimit të cilësisë [Vendim Rektori Nr.50 7.5.2018]. Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë inicion dhe monitoron një sërë procesesh në funksion të përmirësimit të kurrikulave apo cilësisë së mësimdhënies duke prodhuar raporte të cilat paraqiten në nivel Rektorati dhe Senati akademik.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë ka në përbërjen e vet Drejtorin, Koordinatorin dhe 4 anëtarë të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë. Zyra funksionon në nivel Institucioni (jo Njësie Bazë).

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Zyra lehtëson proceset e vlerësimit nga studentët, vetë-vlerësimit të pedagogëve, përmes shpërndarjes së formularëve përkatës [Evidenca 8.2. Model i pyetësorit të studentëve; 8.3. Modeli i pyetësorit online 8.4. Formular vetë-raportimi]. Gjatë vizitës në institucion u kërkua të vihej në dispozicion raporti i fundit i vlerësimit nga studentët [Evidenca 8. Dokumentacion lidhur me sigurimin e cilësisë' Evidenca 8.1. Pjesë nga raporti i vlerësimit të studentëve i semestrit të parë]. Konstatohet se ky dokumentacion ka karakter kryesisht përshkruar, konstatues, kryesisht në lidhje me opinionet e studentëve mbi lëndët dhe



pedagogët. Ndërkohë gjatë vizitës në institucion u konstatua se raportet vetë-vlerësuese të pedagogëve, do të shqyrtohen nga një strukturë relativisht e re në institucion Këshilli i Vlerësimit të Performancës.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Konstatohet se vetëvlerësimet kryhen periodikisht, semestrale dhe vjetore. Pavarësisht mungesës së dokumentacionit mbi mënyrën se si vetë-vlerësimet përkthehen në politika konkrete, gjatë bashkëbisedimit me studentët u konstatua se ata identifikuan më shumë se një rast ku 'zëri' i tyre është dëgjuar përmes ndryshimeve konkrete në çështje që kanë raportuar si problematike.

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>RVB nuk shprehet saktësisht në lidhje me këto kriteret specifike. Informacioni i përfshirë në seksionin përkatës në RVB i përket një fakulteti tjetër, çka ngre dyshime mbi origjinalitetin e raportit (copy paste nga raporte të tjera) dhe profesionalizmin e autorëve.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p>	<p>Pavarësisht kësaj, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se Institucioni ndjek një metodologji të caktuar vlerësimi (semestrale dhe vjetore) duke përdorur gjithashtu instrumenta matës specifikë [Evidenca 8.2. Model i pyetësorit të studentëve; 8.3. Modeli i pyetësorit online 8.4. Formular vetë-raportimi].</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>GVJ konstatoi se mungon ende një reflektim i institucionit në lidhje me rezultatet e pritshme apo synimet përkatëse në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. 	<p>Sondazhi është mënyra e përzgjedhur për sa i përket metodave të tërthorta. Ndërkohë metodat e drejtpërdrejta përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
<p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të 	

<p>analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>SHLUJ UMB është akredituar për herë të parë me Urdhër të MAS Nr. 288, datë 04.09.2009. Akreditimi i fundit Institucional daton 07.04.2017, dhe ka kohëzgjatje 6 vjeçare, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 9, datë 07.04.2017.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>Konstatohet se vetëvlerësimet kryhen periodikisht, semestrale dhe vjetore duke përdorur gjithashtu instrumenta matës specifike [Evidenca 8.2. Model i pyetësorit të studentëve; 8.3. Modeli i pyetësorit online 8.4. Formular vetë-raportimi]. Në përpjekje për përmirësimin e cilësisë institucioni ka ngritur një strukturë të re, “Këshillin e Vlerësimit të Performancës”, e cila do shqyrtojë specifikisht performancën e stafit, duke marrë parasysh të dhënat nga një sërë burimesh, përfshi studentët, eprorët, vetëvlerësimi [Evidencë 13, Vendim i Senatit për Ngritjen e KVP]. Gjatë bashkëbisedimeve me studentët dhe stafin akademik, ata treguan se ishin në dijeni mbi procesin e sigurimit të cilësisë dhe mënyrën sesi janë përfshirë në këtë proces. GVJ gjithashtu gjeti evidencë për ndërtimin e një strategjie konkrete për përmirësimin e cilësisë. Por procedurat dhe politikat për përmirësimin e cilësisë nuk janë të publikuara online dhe të aksesueshme për publikun e gjerë.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p>	
<p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p>	
<p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	
<p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Institucioni ka bërë përpjekje në drejtim të ndërtimit të një strukture për vlerësimin e brendshëm të cilësisë si dhe instrumentave përkatës si dhe drejt rregullimit përmes një strategjie konkrete e cila vendos objektiva të matshëm.</p>	
<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura në funksion të përmirësimit të cilësisë si edhe rezultatet përkatëse nuk janë të publikuara dhe të aksesueshme.</p>	
<p>Mungon ende evidenca mbi mënyrën sesi rezultatet e raporteve të kontrollit të cilësisë përkthehen në politika apo vendimarrje konkrete.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore



Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni dhe objektivat e programit Bachelor në Psikologji shprehen në Rregulloren e Programit të Studimit [Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit]. Rregullorja liston kompetencat e përgjithshme dhe ato specifike me të cilat aftësohet studenti në përfundim të këtij programi studimi. Planet mësimore për të tre vitet akademike paraqesin modulet/lëndët e ndara në semestra me numrin përkatës të krediteve (60 ECTS për cdo vit akademik). Në vitin e tretë, studentët zhvillojnë praktikën profesionale e cila mbart peshën e 4 ECTS [Evidenca 10. Paketa e Praktikës] si dhe provimin e formimit 6 ECTS [Evidenca 11. Program për provimin e formimit] Në RVB thuhet se me qëllim rritjen e peshës së lëndëve të psikologjisë plani mësimor është ndryshuar në masën 20%, duke zëvendësuar lëndët e fushave të tjera, si sociologji, ekonomi apo fusha juridike me lëndë specifike të psikologjisë. [Evidenca 4.1. Shkresë përcjellëse MASR për ndryshimin e planit mësimor 20%; Evidenca 4.2. Vendim i senatit për miratimin e planit mësimor BA Psikologji me 20%; Evidenca 4.3. Miratimi nga ministria i ndryshimit të planit mësimor]

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Bachelor në “Psikologji” është licensuar me shkresë të MASH Nr.2365 dt.12/04/2006 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në SHLUJ “Marin Barleti” dhe akredituar për herë të parë në 16.08.2013. Programi synon të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe specifike, duke i aftësuar ata të angazhohen në shkencën dhe praktikën në fushën e psikologjisë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor i paraqitur në RVB, i kategorizon veprimtaritë formuese nga A-F dhe në secilin vit akademik studenti grumbullon 60 ECTS, 180 ECTS në total në përfundim të studimeve. Plani mësimor sipas kategorizimit A-F shfaq problematika në mënyrën e kategorizimit të lëndëve sipas veprimtarive formuese. Për shembull lëndë karakterizuese të programit si Psikologji Zhvillimi, Teoritë e Personalitetit apo Testim dhe Vlerësim Psikologjik janë në kategorinë C dhe jo B, ndërkohë që kategoria B mbart lëndë si Antropologjia Sociale, që është qartësisht jo karakterizuese e programit. Në total, kategoria A mbart 34 ECTS ose 19% të krediteve; Kategoria B ka 84 ECTS ose 47% të krediteve, Kategoria C mbart 35 ECTS ose 19% të krediteve. Gjithashtu Kategoria D mbart 5 kredite (3% të krediteve), Kategoria E 16 ECTS (9% të krediteve) dhe Kategoria F 6 ECTS (3% të krediteve). Përsa i

përket shpërndarjes së krediteve sipas Veprimtarive Formuese (Udhëzim i 2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë), mospërputhja më e madhe vërehet në kategorinë C, e cila duhet të mbartte rreth 10% të peshës së krediteve, ndërkohë që ka mbartur 19%, dhe kategoria D që mbartte 3%, ndërkohë që sipas Udhëzimit duhet të kapte 7-8%.

Institucioni ka dorëzuar dokumentacion shtesë planin mësimor të paraqitur sipas veprimtarive formuese A-E [Evidenca 9. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive A-E]. Përsa i përket ndarjes së Veprimtarive A-E, kategoria A mbart peshën e 28 ECTS (15.5% të numrit të krediteve), kategoria B 96 ECTS (53.3% të numrit të krediteve), Kategoria C 28 ECTS (15.5% të numrit të krediteve), kategoria D 22 ECTS (12.2% të numrit të krediteve) dhe Kategoria E, 6 kredite (3.3% të numrit të krediteve). Në planin mësimor sipas veprimtarive A-E institucioni ka riorganizuar programin duke zhvendosur lëndët që përmenden më lart nga kategoria C në kategorinë B, dhe nga kategoria B në kategorinë D (Antropologjia Sociale). Gjithashtu pesha e krediteve që mbart çdo kategori është përgjithësisht në përputhje me VKM datë 24.01.2018, Për elementët e programeve të studimit, përveç dy rasteve: 1. Në kategorinë C, pesha e krediteve duhet të jetë mes 12-15%, ndërkohë që është 15.5% dhe 2 Shumatorja e Veprimtarive A+B duhet të jetë jo më pak se 70% por rezulton 68.8%.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

▪ Për leksionet	12 orë në auditor dhe	13 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	10 orë në auditor dhe	15 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	90 orë në auditor dhe	10 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	10 orë në auditor dhe	140 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Ndryshimet në planin mësimor janë kryer me qëllimin e rritjes së peshës së lëndëve specifike të psikologjisë; pra janë zëvendësuar lëndët e fushave të tjera, si sociologji, ekonomi apo fusha juridike me lëndë specifike të psikologjisë. Në vitin I lënda Mendimi Ekonomik është zëvendësuar me lëndën Biologji Humane dhe Psikofiziologji (6 ECTS) dhe lënda Elementë të së drejtës publike zëvendësohet me lëndën Psikologji Zhvillimi e cila kthehet në lëndë vjetore (6 ECTS) (Total për vitin e parë 12 ECTS ose 20%). Në vitin e dytë lënda Psikologji Abnormale ndryshon emërtimin në Psikopatologji, për të evituar konotacionin negativ të fjalës 'abnormale' (7 ECTS), por nuk paraqet ndryshime në syllabus. Ndërsa lënda Sociologji e familjes është zëvendësuar me grup lëndësh me zgjedhje : Hyrje në Psikologji Shkollore, Hyrje në Psikologji ligjore dhe Hyrje në Psikologji Shëndeti dhe Sportive (5 ECTS). Gjithashtu lënda Sociologji e Kulturës dhe Artit zëvendësohet me lëndën Psikodiagnostikë (7 ECTS). Në total për vitin e dytë ndryshimi kap masën e 12 ECTS ose 20%. Në vitin e tretë, lënda Sociologji e Punës dhe Migracionit zëvendësohet me lëndën Testim dhe Vlerësim Psikologjik dhe lënda Sociologji Politike zëvendësohet me lëndën Cështje ligjore dhe etikë profesionale (6 ECTS secila, 12 ECTS në total, ose 20%)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotëso Tabelën ne Aneks)

Personeli akademik efektiv mbulon rreth 65% të ngarkesës mësimore dhe vërehet një përputhshmëri e përgjithshme mes fushës së ekspertizës dhe lëndëve ku janë titullarë. Përsa i përket personelit akademik

me kontratë, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi një mospërputshmëri mes fushës së ekspertizës (CV e stafit) dhe lëndëve që mbulon (3 lëndë).

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset janë hartuar sipas një formati të standardizuar i cili përfshin gjithë komponentët e nevojshëm si: Emërtimi i lëndës/modulit, viti dhe semestri, pedagogu, njohuritë/kompetencat që pritet të fitohen përmes lëndës, tematikat përkatëse, format e mësimdhënies dhe vlerësimit si dhe literatura përkatëse e detyruar dhe ndihmëse.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve kanë një format dhe strukturë të unifikuar ku përfshihen të gjithë elementët e nevojshëm. Tematikat e çdo jave janë të specifikuara qartë dhe kanë koherencë të përgjithshme. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar është specifikuar për çdo syllabus; në disa raste pedagogu i lëndës është autor i literaturës së përdorur cka konsiderohet një avantazh (psh. Psikologji Zhvillimi). Në disa syllabuseve vihet re dhe përfshirje e literaturës në gjuhën angleze (psh., si literaturë e rekomanduar. Konstatohet një lapsus me syllabusin e ‘Psikoterapi’, përmbajtja e të cilës i referohet në fakt lëndës ‘Teori Personaliteti’ (mospërputhje mes titullit të syllabusit dhe përmbajtjes) [Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se Programi Bachelor në Psikologji është akredituar me Urdhër të MASH Nr. 337, dt.16/08/2013, sipas Vendimit 505, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit. Programi ofrohet me kohë të plotë dhe cdo vit akademik studenti grumbullon 60 ECTS, dhe 180 ECTS në përfundim të studimeve. Programi është në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve.
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;	Gjatë vizitës në institucion, dhe takimeve me pedagogë e studentë GVJ konstatoi se Departamenti është njësi përgjegjëse për informimin e studentëve në lidhje me programin e studimit dhe lëndët përkatëse. Informimi kryhet në fillim të vitit akademik si dhe në fillim të cdo semestri. Përgjegjësi i Departamentit si dhe pedagogët përkatës të lëndëve japin sqarimet e nevojshme në lidhje me syllabuset, format e vlerësimit, frekuentimin etj.
Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;	
Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin	

informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konstatoi se planet mësimore sipas Veprimtarive A-F kanë mospërputhje me Udhëzimin e 2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (kryesisht në kategoritë C dhe D), ndërsa Planet mësimore sipas Veprimtarive A-E kanë mospërputhje me VKM dt.24.01.2018, përsa i përket peshës specifike të kategorive, psh. peshë specifike e kategorive A+B është më pak se 70%.

Programi i studimit është ndryshuar në masën 20% për të rritur peshën specifike të lëndëve të Psikologjisë. Ndryshimi në secilin rast është argumentuar dhe ka kontribuar në një rritje të cilësisë së programit të ofruar.

Syllabuset e lëndëve kanë strukturë të unifikuar dhe janë ndërtuar në mënyrë cilësore.

Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit pajis studentët me gjithë informacionet e nevojshme për procesin mësimor, ngarkesën, detyrimet, programet etj.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia organizohet në leksione dhe seminare. Kontrolli i njohurive realizohet përmes disa modaliteteve të cilat janë specifike për lëndët por gjithsesi ndjekin parimin e përgjithshëm 50-50; ku 50% e vlerësimit realizohet gjatë semestrit (psh., 10% ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, 20% detyra dhe 20% testime gjatë vitit) dhe 50% nga provimi përfundimtar [Evidenca 8 Syllabuset e lëndëve]. Gjatë vizitës në Institucion pedagogët dhe studentët vlerësuan si pozitiv faktin e zhvillimit të mësimit në grupe të vogla, gjë që promovon më tepër përdorimin e metodave interaktive në mësimdhënie. Cilësia e mësimdhënies i nënshtrohet një vlerësimi të brendshëm semestral ku studentët raportojnë në lidhje me pedagogët dhe lëndët specifike [Evidenca 8.1. Pjesë nga raporti i vlerësimit të studentëve të semestrit të parë 2018-2019]. Përsa i përket aktivizimit të studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, gjatë vizitës në institucion u konstatua se përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë në mbledhje departamenti ku sjellin propozime apo çështje të ndryshme që i shqetësojnë; gjithashtu studentët marrin pjesë dhe në aktivitete të tjera si ëorkshope apo leksione të hapura të iniciuara nga departamenti [Evidenca 7.1 Një javë një libër; Evidenca 7. Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ku janë angazhuar studentët].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Format e mësimdhënies përfshijnë leksionet e pedagogut dhe seminarët, gjatë të cilave studentët mund të zhvillojnë prezantime apo detyra. Nga shqyrtimi i syllabuseve si dhe Tabela 13 në anekse vërehet se në varësi të lëndës (më tepër fokus teorik apo praktik) raporti leksion/seminar varion nga 1:1 në 2:1. Praktika lëndore nuk përfshihet në asnjërën prej lëndëve ndërsa praktika profesionale kryhet në vitin e fundit nën drejtimin e njërës prej pedagogëve.

Format e kontrollit të njohurive

Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave me studentët dhe stafin akademik GVJ konstatoi se kontrolli i njohurive realizohet përmes disa modaliteteve të cilat janë specifike për lëndët por gjithsesi ndjekin parimin e përgjithshëm 50-50; ku 50% e vlerësimit realizohet gjatë semestrit (psh., 10% ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, 20% detyra dhe 20% testime gjatë vitit) dhe 50% nga provimi përfundimtar). Kontrolli i vazhdueshëm është një element i vlerësuar pozitivisht si nga stafi dhe studentët. Studentët vlerësohen me sistemin nga 0-100 pikë, ku nën 50 pikë studenti konsiderohet ngelës; nota 10 është nga 96-100 pikë [Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit; Evidenca 8. Silabuset]

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

GVJ konstatoi se përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë në mbledhje departamenti ku sjellin propozime apo çështje të ndryshme që i shqetësojnë. Një tjetër rrugë aktivizimi/ përfshirje u identifikua përmes tutoriatit dhe Dekanit të studentëve. Gjithashtu gjatë bashkëbisedimit studentët përmendën pjesëmarrjen në aktivitete të organizuara nga Departamenti, të lidhura me lëndë të caktuara (ëorkshop, leksione të hapura) ose dhe aktivitete ekstra-kurrikulare, vullnetarizëm etj. [Evidenca 7. Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ku janë angazhuar studentët]

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Evidenca 7. Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ku janë angazhuar studentët

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Institucioni ndjek procedura të qarta dhe të dokumentuara për pranimin e studentëve. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët janë të informuar për programin e studimit kryesisht përmes Dekanit të studentëve, Përgjegjësit të Departamentit apo dhe pedagogëve përkatës. Studenti nënshkruan marrëveshjen e regjistrimit ku shprehen qartazi të drejtat dhe detyrimet [Evidenca 12. Marrëveshje e

rregjistrimit të studentit]. Kohëzgjatja e studimeve për këtë program studimi është 3 vjet, dhe afati maksimal nuk mund të kalojë dyfishin e kohëzgjatjes normale (6 vjet) [Evidenca 12. Marrëveshje e regjistrimit të studentit].

Regjistrimi bëhet në periudhën e përcaktuar nga MASR, për studentët të cilët kanë përzgjedhur UMB përmes sistemit U-Albania. Për vitin akademik 2018-2019, kriter në hyrje është vendosur nota mesatare, 7. Për shkak të specifikave të profesionit të psikologut dhe në përputhje me “Ligjin për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, punësimi në profesion vetëm me një cikël studimesh nuk është i mundur. Ky fakt shpjegon shifrat 0 të punësuar në përputhje me diplomën nga viti 2016 e në vazhdim, dhe rritjen e numrit të të punësuarve jo në përputhje me diplomën (Evidenca: RVB)

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Institucioni ndjek procedura të qarta në lidhje me pranimin e studentëve. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim është përcaktuar qartë (Evidenca 6.3. Rregullore Akademike SHLUJ Universiteti Marin Barleti).

Regjistrimi bëhet në periudhën e përcaktuar nga MASR, për studentët të cilët kanë përzgjedhur UMB përmes sistemit U-Albania. Pas dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm, studenti nënshkruan marrëveshjen e regjistrimit ku shprehen qartazi të drejtat dhe detyrimet [Evidenca 12. Marrëveshje e rregjistrimit të studentit].

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, tashmë kriter në hyrje është vendosur nota mesatare 7. Përsa i përket viteve të kaluara akademike vërehet një rritje e notës mesatare të studentëve në dalje për vitet akademike 2014-2015; 2015-2016 me përafërsisht 1 notë.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare.

Nga kontrolli i Regjistrimit Themeltar u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë ishte 6. Kjo shifër përputhet me atë të raportuar në RVB.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nga kontrolli i Regjistrimit të Diplomave GVJ konstatoi përputhshmëri me shifrat e deklaruara në RVB-18 studentë të diplomuar në vitin e fundit.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Gjatë shqyrtimit të Regjistrimit Themeltar, GVJ konstatoi se nga viti 2015 në vazhdim janë kryer 5 transferime. Transferimet janë kryer me shkresë të posacme, dhe mungon evidenca për dosje specifike të studentit me programet e lëndëve nga institucioni dërgues.

Të dhëna për punësimin e studentëve

RVB paraqet të dhëna të pjesshme në lidhje me punësimin e studentëve pas diplomimit. RVB gjithashtu thekson se Ligji për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë” vendos kriterin e të paktën 2 cikle studimi, për anëtarësim në urdhër, cka e ben të pamundur punësimin e të diplomuarve Bachelor në profesion.

Numri total të diplomuarve

Nga kontrolli i Regjistrimit të Diplomave GVJ konstatoi përputhshmëri me shifrat e deklaruara në RVB (15 të diplomuar 2016-2017 dhe 18 të diplomuar 2017-2018)

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Si kundër theksohet në RVB si dhe në “Ligjin për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, anëtarësimi në urdhër kërkon minimalisht 2 cikle studimi. Ky fakt shpjegon shifrat 0 të punësuar në përputhje me diplomën nga viti 2016 e në vazhdim.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

RVB paraqet të dhëna mbi numrin e të punësuarve jo në përputhje me diplomën; Në vitin 2016-2017 73% e të diplomuarve janë në këtë kategori ndërsa në vitin 2017-2018 vetëm 55%. Pjesa tjetër e të diplomuarve 2017-2018 deklarohen që janë duke ndjekur studimet Master (në përputhje me Ligjin për “Urdhrin e Psikologut”)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se pranimi në ciklin e parë të studimeve kryhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Regjistrimi bëhet në periudhën e përcaktuar nga MASR, për studentët të cilët kanë përzgjedhur UMB përmes sistemit U-Albania.</p> <p>Kandidatët në vitin akademik 2018-2019 I janë nënshtruar një kriteri shtesë, që është nota mesatare 7 (VKM 216, dt.20.04.2018 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë.”</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët janë të informuar për programin e studimit kryesisht përmes Dekanit të studentëve, Përgjegjësit të Departamentit apo dhe pedagogëve përkatës.</p> <p>Studentët gjithashtu konfirmuan kryerjen e një vlerësimi semestral për çdo lëndë dhe pedagog. Përsa i përket këshillimit të karrierës, apo mundësive për punësim pas diplomimit studentët identifikuan Dekanin e studentëve si personin i cili angazhohet në këtë aspekt.</p>

Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.	
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	Gjatë vizitës në institucion dhe kontrollit të Regjistrat Themeltar, Rregjistrat të Arritjeve Akademike dhe Rregjistrat të diplomave, GVJ konkludoi se Institucioni ka në dispozicion të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar, si dhe arritjet e tyre akademike. Gjithashtu institucioni disponon të dhëna mbi studentët e diplomuar.
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	GVJ konstatoi se studentët identifikojnë Dekanin e studentëve si personin kyc në lidhje me diskutimin e çështjeve mbi procesin mësimor apo këshillimin e karrierës. Praktika profesionale udhëhiqet nga departamenti (pedagogu përgjegjës) në bashkëpunim me zyrën e Karrierës dhe Alumni (Evidenca 6.1. Rregullore e Departamentit)
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni ndjek procedura të qarta për pranimin e studentëve në programin e studimit</p> <p>Studentët udhëzohen dhe mbështeten që në fazën e pranimit dhe përgjatë studimeve të tyre deri në diplomim nga departamenti, pedagogët, dekani i studentëve, zyra e karrierës dhe alumni.</p>	


KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Përpyekjet e institucionit për të fuqizuar kërkimin shkencor reflektohen në ndryshimet e fundit në strukturat drejtuese duke krijuar pozicionin e Zv.Rektorit për Kërkim dhe Zhvillim si dhe Koordinatorit për Kërkim dhe Zhvillim (Evidenca RVB). Megjithëse mungon një strategji e mirëfilltë e aprovuar e kërkimit shkencor,



gjatë vizitës në institucion dhe takimit me personat përgjegjës që mbulojnë këto pozicione, u vunë gjithashtu në dispozicion dokumente pune të cilat dëshmojnë lëvizje në këtë drejtim (Evidence 14.1 Dokumente pune (pjesë të shkeputura) për përmirësimin e strategjive për kërkimin shkencor në nivel institucioni.pdf). Politikat e kërkimit shkencor në institucion vërehet se janë të orientuara drejt Elikës së Katërfishtë: Akademi-Industri-Shoqëri-Qeverisje. Institucioni gjithashtu nxit pjesëmarrjen e stafit në aktivitete kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, projekte si dhe botime artikujsh shkencorë (Evidenca 8.4. Formular Vetë-raportimi; Evidenca 8.5 Model Plan Veprimi i Njësisë Bazë).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Të dhënat për kërkimin shkencor janë paraqitur në nivelin makro (RVB, faq. 79). Gjithashtu dokumenti i vënë në dispozicion gjatë vizitës është një raport përmbledhës për vitin 2016 sërisht në nivel makro (Evidenca 14.2. Raport mbi punën shkencore 2016+). Përsa i përket specifikisht programit të studimit, raportohen 4 aktivitete, konferenca, simpoziume apo workshope. RVB raporton se të gjithë pedagogët dhe studentët marrin pjesë në këto aktivitete të institucionit; gjithsesi mungon evidenca dokumentare për prezencën apo angazhimin e aktorëve të ndryshëm në këto aktivitete. Gjithashtu mungon evidenca e dokumentuar mbi konstatimin e GVB se ‘të gjithë studentët dhe pedagogët janë përfshirë në forma të ndryshme të kërkimit shkencor’ [RVB, faq. 79].

Përfundimisht GVJ konstaton se institucioni po bën përpjekje serioze në funksion të ndërtimit të infrastrukturës së kërkimit shkencor sidomos në nivel të Njësisë Bazë. Gjithsesi evidenca dokumentare, sidomos në lidhje me programin specifik të studimit ka ende mangësi.


11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe organizata profesionale. Sipas RVB këto marrëveshje përfshijnë 25 institucione të huaja të arsimit të lartë dhe 29 institucione shqiptare. Gjithashtu Përpjekjet e institucionit për ndërkombëtarizim reflektohen në përfshirjen tek Katedra Jean Monet, Katedra Unesco dhe Erasmus +. Institucioni gjithashtu disponon një sërë marrëveshjesh me organizata profesionale (5) dhe një Klinikë të shëndetit mendor – marrëveshje të cilat janë në funksion të lidhjeve me tregun e punës. Studentët e programit të studimit janë përfshirë në një sërë projektesh që kanë rezultuar nga këto marrëveshje [Evidenca 7. Projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare ku janë përfshirë studentët].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)

GVJ konstatoi marrëveshje të institucionit me një sërë institucionesh të tjera homologe brenda dhe jashtë vendit, përfshi 25 institucione të huaja të arsimit të lartë dhe 29 institucione shqiptare. Gjatë vizitës në institucion, u vu në dispozicion një document që liston projektet konkrete ku janë përfshirë studentët (Evidenca 7. Projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare ku janë përfshirë studentët; Evidenca 7.1. Një javë një libër një dritare e re). Gjithsesi mungon një analizë në nivel departamenti në lidhje me efektivitetin/outcome konkret të marrëveshjeve specifike.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

RVB liston bashkëpunime me Bashkinë Tiranë, një sërë organizatash profesionale si Doën Syndrome Albania apo Kryqi i Kuq, një klinikë të Shëndetit Mendor 'Venis' etj. Nga ana tjetër u konstatua se e vetmja mënyrë sesi këto marrëveshje janë përdorur në funksion të realizimit të programeve, ishte përmes kryerjes së praktikave profesionale. Sërisht mungon një analizë në nivel departamenti në lidhje me efektivitetin/outcome konkret të marrëveshjeve specifike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Gjatë vizitës në institucion dhe bashkëbisedimit me stafin akademik dhe administrativ, GVJ konstatoi se personeli akademik percepton një klimë bashkëpunimi në institucion jo vetëm brenda departamentit por edhe ndërmjet departamenteve. Gjithashtu vërehet një angazhim i stafit të departamenteve të tjera në programin specific (psh. Departamenti i Shkencave Politike, Departamenti i Arkitektures dhe Shkencave Kompjuterike [Evidenca: Tabela 4. Stafi akademik për Programin e Studimit].
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	GVJ konstatoi marrëveshje të institucionit me një sërë institucionesh të tjera homologe brenda dhe jashtë vendit, përfshi 25 institucione të huaja të arsimit të lartë dhe 29 institucione shqiptare. Gjithashtu për kryerjen e praktikës profesionale u identifikuan 5 organizata profesionale dhe 1 klinikë të shëndetit mendor. Ndërsa vërehet një përpjekje e institucionit për të ngritur marrëdhënie bashkëpunimi dhe për ti përdorur në funksion të praktikës profesionale, GVJ konstatoi mungesën e evidencës për trajnime profesionale në bashkërendim me punëdhënësit. Gjithashtu institucioni nuk paraqiti evidencë të një raporti analitik për vlerësimin e marrëveshjeve në funksion të realizimit të programeve.
Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;	


Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Konkluzionet e vlerësimit:

Institucioni po bën përpjekje të dukshme për ndërtimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me aktorë kombëtarë e ndërkombëtarë.

Mungon ende evidenca e analizës/vlerësimit sistematik të efektshmërisë së këtyre marrëveshjeve në funksion të realizimit të programeve të studimit.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Për rekomandimin e parë: “Të ndërtohen sa më shpejt laboratorë për programin e studimit në nivelin Bachelor” GVJ konstaton se ky rekomandim është **përbushur pjesërisht**.

Për rekomandimin e dytë: “Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e vogël të studentëve të pranuar në një vit shkollor” GVJ konstaton se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**.

Për rekomandimin e tretë: “Të shikohet mundësia që një departament mos mbulojë një numër të madh programesh të nivelit Bachelor (4 programe)” GVJ konstaton se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Kurrikula bashkëkohore i jep një bazë mjaft solide studentëve për ndjekjen e ciklit pasues të studimeve.
- 2) Mësimdhënia me grupe të vogla lejon shkallë më të lartë ndërveprimi pedagog-student
- 3) Mbështetja ndaj studentit është maksimale, informimi dhe këshillimi i karrierës kryhen në mënyrën më cilësore që në rregjistrim e deri në diplomim.

b. Pika të dobëta:

- 1) Biblioteka është e varfër në tituj nga fusha e Psikologjisë.
- 2) Megjithëse Institucioni po bën përpjekje për ndërtimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me aktorë kombëtarë e ndërkombëtarë, ende mungon evidenca e një analize/vlerësimi sistematik të efektit/rezultatit të këtyre marrëveshjeve në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Psikologji”.
- 3) Personeli akademik me kohë të plotë përbën vetëm 50% të stafit të angazhuar në Programin e studimit dhe nuk ka asnjë titullar lënde të kategorisë Profesor.
- 4) Mungon evidenca se gjetjet nga raportet e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë reflektohen në politika apo vendimarrje konkrete në institucion.
- 5) Megjithëse institucioni po bën përpjekje serioze në funksion të ndërtimit të infrastrukturës së kërkimit shkencor, mungon evidenca dokumentare, psh., strategjia për zhvillimin e kërkimit shkencor, objektiva konkretë etj. sidomos në nivel të Njësisë Bazë.
- 6) Mungon një proces i standardizuar për transferimet e studentëve nga institucione të tjera.

c. Mundësitë:

- 1) Rregullimi i profesionit të psikologut çon në rritjen e kërkesave të tregut për këtë këtë program studimi.
- 2) Marrëveshjet me institucionet ndërkombëtare mund të prodhojnë programe të përbashkëta në fushën e Psikologjisë në të ardhmen.

d.Pengesat:

- 1) Vendosja e mesatares 7.5 si kriter në hyrje për Programet e Studimit Bachelor në Psikologji do të reduktojë numrin e studentëve.
- 2) Programi Bachelor në Psikologji ofrohet nga një numër i madh Institucioneesh të Arsimit të Lartë, publike e jo-publike në vend.

Rekomandime

1. Të pasurohet biblioteka me tituj nga fusha e Psikologjisë (hard-copy dhe online).
2. Të realizohet në nivel Njësie Bazë një analizë/vlerësim sistematik i efektshmërisë së marrëveshjeve me aktorë kombëtare e ndërkombëtare në funksion të realizimit të programit të studimit.
3. Të rritet numri i anëtarëve të personelit akademik efektiv në funksion të realizimit të programit të studimit dhe të shihet mundësia e rekrutimit të stafit me titull Profesor.
4. Të konsolidohet më tej Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, duke vërtetuar rolin e tij konkret në përmirësimin e politikave specifike në Institucion.
5. Të zhvillohet një strategji/plan-veprimi për nxitjen/promovimin e kërkimit shkencor në nivel Departamenti.
6. Të rregullohet procesi i transferimit të studentëve përmes një dokumenti të vecantë, që specifikon: komisionin e ngritur për këtë qëllim, dokumentacionin përkatës në dosjen e studentit, kriteret përkatëse etj.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. Asoc. Dr. Erika Melonashi

2. Dr. Blerta Bodinaku

SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

I. SUMMARY ANALYSIS OF FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

For the first recommendation “**To build laboratories for the specific program of study at the Bachelor level**” the recommendation was partly met by the institution.

For the second recommendation “**To make efforts towards increasing the small number of students in each academic year**”, the recommendation was fully met by the institution.

For the third recommendation: “**To consider the possibility that the same department should not have a large number of Bachelor level programs (4 programs)**”, the recommendation was fully met by the institution.

II. SUMMARY ANALYSIS OF THE RVJ BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

a.Strengths:


- 1)The up-to-date curriculum provides a solid basis for pursuing post-graduate studies in Psychology.
- 2) Teaching in small groups enables a higher level of interaction between students and lecturers.
- 3) The institution provides maximal support to students, by providing relevant information and career counseling from the moment of registration till their graduation.

b.Weaknesses:

- 1)The library has very few titles of psychology books and journals.
- 2) Although the institution is making efforts towards establishing cooperation agreements with national and international actors, there is no evidence of a systematic evaluation/analysis of the outcomes of these agreements in the context of the specific study program, Bachelor in Psychology.
- 3)Full-time academic staff comprises only 50% of the staff engaged in the program of study and there are no lecturers with the title ‘Associate Professor’ or ‘Professor’.
- 4)There is no evidence that findings from the internal quality assurance reports are reflected onto actual policies or decision making at the institution.
- 5)Although the institution is making serious efforts towards building a research infrastructure, documentary evidence is still scarce especially at the Department level (e.g., strategy for the development of scientific research, concrete objectives etc.)
- 5)There is no standardized procedure for transfer of studies from other institutions.

c.Opportunities:

- 1)As Psychology entered the list of Regulated Professions in Albania, there is an increase of market demand for this program of study.



2)Agreements with international institutions might produce joint programs of study in Psychology.

d.Threats:

1)Admission criteria requiring a GPA of 7.5 or higher, will reduce the number of students in the study program.

2)Several public and private higher education institutions offer the Program Bachelor in Psychology.

Recommendations:

1. To enrich the library with titles (books and journals) in Psychology (hard-copy and online)

2. To perform a Department analysis/systematic evaluation of the results of cooperation agreements with national and international partners in the context of the specific study program.

3. To increase the number of full-time academic staff for the specific program of study and to consider the possibility of recruiting Professors or Associate Professors.

4. To consolidate further the role of the Internal Quality Assurance System, by demonstrating a clear role of the Unit into improving actual policies/practices at the institution.

5. To create a strategy/action plan for promoting scientific research at the Departmental level.

6. To standardize the process of student transfer/transfer of studies from other institutions with a specific document; the document needs to specify the criteria for student transfer, the specific documents in the student folder, the commission responsible for evaluating the documents, etc.

External Evaluation Group

1. Prof. Asoc. Dr. Erika Melonashi

2. Dr. Blerta Bodinaku